



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 354/3 Prot.

Tiranë, më 23.03.2021

V E N D I M

Nr. 49, Datë 23 / 03 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 23, datë 23.02.2021, të paraqitur nga J.B kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Ka qenë duke qëndruar në Sheshin “Luigj Gurakuqi”, kur i është ofruar punonjësi i policisë, M.G i cili e ka kërcënuar duke i thënë që të ikte në shtëpi ose do e dërgonte në komisariat. Në datë 29.01.2021 është thirrur nga inspektori i lagjes, i cili e ka vënë në dijeni se do të takonte P.Ç, Shef i Komisarariatit Shkodër. Në datë 29.01.2021 kanë takuar Shefin e Komisarariatit, i cili e ka marrë në pyetje pa praninë e psikologut dhe në mënyrë të jashtëligjshme. Dhe në komunikimet telefonike, P.Ç është sjellë në mënyrë arrogante dhe diskriminuese duke e etiketuar si person me probleme psikike, duke i thënë, “ik se ju jeni i marrë”. Për ngjarjen ka bërë ankesë tek portali i bashkëqeverisjes dhe ka marrë përgjigje me Shkresën nr. 724/1, datë 04.02.2021. Përgjigja e Shefit të Komisarariatit ka qenë ofenduese dhe diskriminuese pasi e ka etiketuar si person me probleme psikike dhe nuk është e vërtetë që ai shqetëson punonjësit e policisë në punën e tyre, por duke qenë se punonjësit e policisë janë në dijeni të sëmundjes së tij e bullizojnë dhe e ofendojnë herë pas here”.*

¹ Referuar dosjes nr. 1061, datë 03.09.2020 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, dhe Informacionit mjekësor, datë 16.07.2020 të mjekut kurues, Gj.P, shtetasi J.B është invalid me diagnozë: Epilepsi kronike me turbullime të personalitetit epileptik.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe të mos ofendohet më nga punonjësit e policisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 23, datë 23.02.2021 të shtetasit J.B u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 354/1, datë 01.03.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Komisioneri paraprakisht informoi Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, se nëse prej tyre do të ndërmerreshin masa të menjëhershme lidhur me rregullimin e problematikës së ngritur nga ankuesi, Komisioneri do të ndërpriste procedurën hetimore, duke e konsideruar të zgjidhur rastin.

Me shkresën nr. 1361/3, datë 09.03.2021, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Bazuar në informacionet paraprake që disponohen, si rrjedhojë e deklarimeve të dhëna nga punonjësit e policisë dhe të dhënave të tjera të siguruara në rrugë operative nga specialisti i policisë së zonës, rezulton se, punonjësit e policisë të patrullës së përgjithshme, E.H, V.N dhe M.G, në ushtrim të detyrave që u ngarkon funksioni policor, janë përfshirë natyrshëm në përmirësimin e situatës aktuale të pandemisë që ndodhet vendi ynë, nëpërmjet disiplinimit të shtetasve për vendosjen e maskës mbrojtëse ndaj virusit COVID-19, duke ndërmarrë eventualisht masa ndëshkuese për shtetasit që dështonin në respektimin e një kërkesë të tillë. Gjatë ushtrimit të detyrës, këta punonjës policie, sipas deklarimeve të dhëna tek eprorët dhe tek struktura e ShÇBA-së Shkodër, janë shprehur se shtetasi J.B, në mënyrë të përsëritur, ka penguar ushtrimin e rregullt të detyrës nga punonjësit e policisë të sipërpërmendur, duke ndërhyrë dhe moslejuar nganjëherë përpilimin e procesverbaleve për vendosje gjobe nga mosmbajtja e maskave ndaj shtetasve të tjerë. Sipas këtyre deklarimeve nga punonjësit e policisë të cituar, rezulton se sjellja e tyre përkundrejt shtetasit J.B, në kuadër të pengesave në ushtrimin e detyrës policore të krijuara nga ana e tij, ka qenë vazhdimisht korrekte dhe asnjëherë e shoqëruar me shprehje të karakterit ofendues apo diskriminues ndaj ankuesit. Nga ana tjetër, shtetasi J.B, sipas ankesës së paraqitur në platformën e bashkqeverisjes dhe deklarimeve të dhëna në strukturën ShÇBA-së Shkodër, ka pretenduar se punonjësit e policisë të përmendur më sipër kanë shfaqur sjellje me karakter ofendues dhe diskriminues përkundrejt tij. Nga verifikimi i të dhënave të administruara nga struktura e ShÇBA-së Shkodër, është konkluduar se ankesa referuese nuk mund të vërtetohet. Paraprakisht, vlerësojnë të rëndësishëm theksimin e faktit, se shtetasi J.B, referuar të dhënave me karakter operativ, raportohet se ka krijuar dhe është përfshirë në mënyrë të përsëritur në probleme me banorët e pallatit ku jeton dhe gjithashtu, me struktura institucionale të tjera të administratës shtetërore. Për këtë arsye, kërkesa e ardhjes së shtetasit J.B në ambientet e Komisarariatit të Policisë Shkodër, për t’u dëgjuar mbi ankesën e tij qoftë edhe nga titullari i Komisarariatit të Policisë Shkodër, është vlerësuar dhe pranuar vazhdimisht nga struktura dhe punonjësit e policisë përkatës, madje me disponibilitetin dhe me rëndësinë e veçantë që i është atribuar rastit të shtetasit J.B, me qëllim dhënien e zgjidhjes të përshtatshme të ankesës së tij. Nga ana tjetër, për shkak të ndjeshmërisë ndaj situatës së përgjithshme shëndetësore që e shoqëron ankuesin, shefi i Komisarariatit të Policisë Shkodër, është treguar disponibël duke shfaqur tolerancë të shtuar ndaj tij, nëpërmjet dhënies së mundësisë për të komunikuar edhe personalisht, nëpërmjet vënies në dispozicion të telefonit personal, me qëllim zgjidhjen e shpejtë e të efektshme të ankesave të mundshme që paraqet shtetasi në fjalë dhe për të shmangur nga ana tjetër burokracinë institucionale, që shoqëron parimisht verifikimi dhe zgjidhja e një ankese konkrete nga një shtetas i caktuar. Rezulton lehtësisht e verifikueshme nga tabulatet telefonike, se shtetasi J.B e ka keqpërdorur të drejtën e posaçme që i është*

akorduar nga shefi i Komisarariatit të Policisë Shkodër, duke telefonuar në mënyrë të përsëritur në orare të vona të natës, titullarin e Komisarariatit. Edhe pse të ndodhur në situata të tilla, shefi i Komisarariatit të Policisë Shkodër dhe punonjësit e tjerë të policisë, rezultojnë se gjithmonë sjellja e tyre përkundrejt ankuesit është shoqëruar me ndjeshmëri të lartë, duke qenë e matur, e përshtatshme dhe asnjëherë e karakterizuar me shprehje apo veprime, qofshim këto fyese, poshtëruese apo diskriminuese”.

2. Me e-mail-in datë 10.03.2021, përfaqësuesja e Komisionerit në Zyrën Rajonale Shkodër ka dërguar deklaratën më shkrim të ankuesit J.B.

Në shkresën datë 10.03.2021, subjekti ankues ka deklaruar se tërhiqet nga ankesa kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, pasi punonjësit e policisë të cituar në ankesë i kanë kërkuar ndjesë.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Aftësia e kufizuar, është shkak për të cilin ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me aftësinë e kufizuar.

Bazuar në nenin 7 të Ligjit nr. 10221/2010, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Kjo sanksionohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.*

Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i çenojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos çënimin e tyre dhe nga individë të tjerë, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për ti mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë shtetasit.

Mosdiskriminimi është e drejtë kushtetuese e sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 18 Kushtetuta parashikon *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi janë ndër parimet dhe të drejtat më themelore të legjislacionit që mbron të drejtat e njeriut, pasi ato janë të ndërlidhura me dinjitetin njerëzor dhe janë guri i themelit për të gjitha të drejtat e njeriut. Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*³ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: *“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar”*.

Komisioneri vlerëson se, për të garantuar pjesëmarrjen e barabartë të të gjithë shtetasve në shoqëri dhe për të garantuar të drejtat dhe liritë në baza të barabarta me të tjerët, duhet të eliminohen edhe pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet apo stereotipet negative që për fat të keq konstatohet se përdoren ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Në datë 10.03.2021, subjekti ankuesi ka paraqitur një deklaratë me shkrim me anë të së cilës ka deklaruar se tërhiqet nga ankesa, pasi punonjësit e policisë të cilët e kanë ofenduar i kanë kërkuar ndjesë.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet se: *“Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet se: *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

³Ratifikuar me Ligjin nr 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga J.B, i cili me anë të deklaratës, datë 10.03.2021 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 23, datë 23.02.2021, paraqitur nga J.B kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA